

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2021**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2020

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹.) Burimi: Banka e Shqipërisë

DATA	R/REPO njeditore	R/REPO njejavore	R/REPO >1jave <3muaj	REPO Njeditore
7-Janar-21		12.49		
14-Janar-21		14.40		
21-Janar-21	1.93	20.57		
22-Janar-21	0.64			
25-Janar-21			6.42	
28-Janar-21		19.99		
04-Shkurt-21		16.58		
11-Shkurt-21		10.14		
18-Shkurt-21		19.14		
24-Shkurt-21			4.56	
25-Shkurt-21		22.14		
04-Mars-21		16.95		
11-Mars-21		17.25		
18-Mars-21		20.54		
24-Mars-21			5.39	
25-Mars-21		22.45		

Në tremujorin e parë të vitit 2021, ndërhyrjet e BSh në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë, ka qenë 33.37 mld lekë kundrejt 39.27 mld lekë në 3-mujorin e mëparshëm dhe 27.34 mld lekë në 3-mujorin e parë të vitit 2020.


Kërkesa e bankave për likuiditet në operacionet e Bankës së Shqipërisë është luhatur gjatë periudhës në bandën e gjerë 25.70-39.0 mld lekë për shkak të financimit nga MFE të borxhit të ri në lekë në data të ndryshme nga maturimet, por ka ruajtur prirjen rritëse prej 32.66 mld lekë në fillim të periudhës në 36.82 mld lekë në fund të saj. Rritja e likuiditetit në llogarinë e qeverisë me 5.61 mld lekë, daljet e cash-it me një efekt kumulativ 3.61 mld lekë kanë qenë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e mungesës, ndërkohë që, ulja e tepricës së likuiditetit në llogarinë e RZB me 6.73 mld lekë ka qenë faktori kryesor që ka pasur ndikim në uljen e kërkesës së bankave për likuiditetin në operacionet injektuese të Bankës së Shqipërisë.

¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti

Ndikim më të vogël në injektimet mesatare të periudhës kanë pasur maturimi i marrëveshjeve SWAP nga MFE *vetëm* në javën e fundit të periudhës për 4.90 mld lekë, injektimet e përhershme të Bankës së Shqipërisë nëpërmjet ndërhyrjeve me ankand e të blerjes së valutës nga tregu valutor për afër 2.0 mld lekë, blerja e valutës nga IBRD dhe fondet IPA për 1.41 mld lekë si dhe ulja e portofolit të bonove të thesarit me 465 mio lekë vlerë nominale.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 17.46 mld lekë ose 52.33%. Gjatë vitit 2020, injektimet mesatare javore kanë rezultuar 19.61 mld lekë ose 55.88% e injektimit total në operacionet e Bankës së Shqipërisë. Në përputhje me vendimin e KZKPM, prej javës së dytë të muajit mars 2020, Banka e Shqipërisë ka ndryshuar formën e ankandit nga “ankand me shumë të fiksuar” në “ankand me çmim uniform” ku bankat mund të marrin hua shuma të pakufizuara me normë interesi të njëjtë me normën bazë. Vendimi ka synuar uljen e pasigurisë në sistemin bankar për gjendjen e likuiditetit në cdo bankë.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2021 (me vlerë nominale). Burimi: Banka e Shqipërisë




1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme

Sistemi bankar ka përdorur depozitën në BSH në mënyrë të vazhdueshme për mesatarisht 6.52 mld lekë, kundrejt mesatares prej 6.38 mld lekë në 3-mujorin e mëparshëm dhe mesatarisht 6.58 mld lekë në vitin 2020. RZB ka vijuar të jetë përdoruesja kryesore e instrumentit të depozitës me afër 6.17 mld lekë.

Instrumenti i kredisë njëditore nuk është përdorur në asnjë rast prej datës 9 janar 2020.

1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2021, portofoli i Bankës së Shqipërisë ka rënë me 546 mio lekë në 67.1 mld lekë kundrejt 67.60 mld lekë në fund të vitit 2020. Pas vendimit të KZKPM për të mbajtur vlerën e portofolit të bonove të thesarit në bandën 65.60-69.60 mld lekë gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2020, operacionet e Bankës së Shqipërisë në tregun sekondar të letrave me vlerë kanë synuar rritjen e zotërimit në letrat e reja të emetuara 3, 6 dhe 12 mujore ku zotërimi ishte 0 si dhe uljen e zotërimit në disa emetime 12-mujore ku zotërimi ishte mbi 30%. Gjatë 3-mujorit është ulur pjesëmarrja në ankandet e tregut primar për në total 2.32 mld lekë dhe janë blerë në treg sekondar një ditë pas ankandit të tregut primar 850 mio lekë bono thesari 12-mujore dhe 1 mld lekë bono thesari 3 dhe 6 mujore në 5 ankande të zhvilluara. Në 3 prej 6 ankandeve të blerjes që janë zhvilluar, pjesëmarrja e bankave ka munguar.



Pas rritjes së portofolit në 6 muajt e parë të vitit 2020, në pjesën e dytë të vitit 2020 dhe në 3-mujorin e parë të vitit 2021, luhatjet e portofolit të Bankës së Shqipërisë kanë qenë minimale.

1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës janë kryer 2 operacione rregulluese, në dy ditët e fundit të periudhës së rezervës së detyrueshme që mbyllej në datën 24 janar 2021. Pjesëmarrja e bankave ka qenë e ulët për 1.93 mld lekë dhe 0.64 mld lekë.

2. NDËRHJRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2021

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në përputhje me vendimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare të dt. 22 dhjetor 2020 dhe kalendarin si më poshtë të publikuar në të njëjtën datë, në 3-mujorin e parë të vitit 2021, janë zhvilluar ankandet e muajit shkurt dhe mars.

Kalendari i ndërhyrjeve në treg

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2021

	Data	Shuma Raundi I (në euro)
1	19/02/2021	4-6 mln
2	19/03/2021	4-6 mln
3	15/04/2021	4-6 mln
4	14/05/2021	4-6 mln
5	07/06/2021	4-6 mln
6	21/06/2021	4-6 mln
7	09/07/2021	4-6 mln
8	23/07/2021	4-6 mln
9	06/08/2021	4-6 mln
10	20/08/2021	4-6 mln
11	18/10/2021	4-6 mln
12	18/11/2021	4-6 mln
13	03/12/2021	4-6 mln
14	20/12/2021	4-6 mln

*** Në rastet kur ankandi bie në ditë pushimi, ankandi do të organizohet në ditën pasardhëse të punës.**

Në ankandin e muajit shkurt janë blerë 6.8 mio Euro, ndërsa në ankandin e muajit mars janë blerë 9.3 mio Euro, ku në të dy rastet, Banka e Shqipërisë ka përdorur raundin e dytë përkatësisht për 2.3 dhe 3.3 mio Euro. Kursi i këmbimit Eur/Lek ka pasur luhate mjaft të ulëta gjatë 3-mujorit dhe është luhatur mesatarisht rreth nivelit 123.40 lekë me një tendencë forcuese të lekut drejt nivelit 123.10 lekë kundrejt maksimumit 123.80 lekë të shënuar.

Në lidhjen e mëposhtme mund të gjeni informacion mbi historikun dhe rezultatet e ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në tregun valutë

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet_e_Bankes_se_Shqiperise/Nderhyrjet_ne_tregun_valutor/

2.3 Veprime me institucione të tjera

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2021, në datën 24 mars 2020, MFE ka ulur shumën e marrëveshjeve SWAP të pamaturuara në 40.90 mld lekë kundrejt 45.80 mld lekë në fund të vitit 2020 dhe 50 mld lekë të limitit të miratuar për vitin 2021

Gjatë 3-mujorit të parë, Banka e Shqipërisë ka blerë 6.92 mio Euro nga programi IPA, 4.55 mio Euro nga IBRD dhe i janë shitur ASD 295 mijë Euro.